



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 49, datë 23.07.2025

PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM, QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË Durrës PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË ULJE TË VLERËS SË KONTRATËS PËR VITIN 2025

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 15.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe përparsitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, si dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sipas listës së miratuar nga Komisioni i Strehimit pranë Bashkisë Durrës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e listës emërore hartuar nga Komisioni i Strehimit, të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e grantit të menjëhershëm, që do të akordohet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në favor të Bashkisë Durrës për familjet që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës për vitin 2025, sipas listës bashkëngjitur këtij akti.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 24.07.2025



Tabela nr. 1

Lista e familjeve që përfitojnë nga granti i menjëhershëm nga MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Nr.Familje	EMER/MBIEMER	Gjendja familjare	VKB që e ka miratuar	Statusi (I Verbër, PAK, jetim)	Vlera e Kontratës totale	Vlera e kështit mujor	% e Grantit nga Buxheti	Vlera e grantit që përfiton
1	Festim fiqret Pjeci	4	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1842087	8960	grantit 10 %	184208.7
2	Hanko Rakip Lusha	7	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1875498	9036	grantit 10 %	187549.8
3	MyzejeQani Alizoti	3	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1294155	6322.00	grantit 10 %	129415.5
4	Zahde Abaz Pjeci	7	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1842087	8960	grantit 10 %	184208.7
5	Olgert Myftar Velika	5	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1089605	6759.86	grantit 10 %	108960.5
6	NurimMemet Boto	1	VKB Nr.200 dt.24/02/2010-EKB	b. PAK,	2317848	9824.3	grantit 10 %	231784.8
7	Ibrahim Lekë Leka	4	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	2345590	5936	grantit 10 %	234559
8	Mikel Lash Gjeka	4	VKB Nr.200 dt.24/02/2010-EKB	b. PAK,	2298660	9742.97	grantit 10 %	229866
9	Rajmonada Fejzi Neziri	6	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1132688	5730	grantit 10 %	113268.8
10	Ilir Sotir Tatasi	4	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1030312	5011	grantit 10 %	103031.2
11	Beqir Rexhep Domi	1	VKB Nr.286 dt.13/08/2002-EKB	b. PAK,	1626044	7992	grantit 10 %	162604.4
	TOTALI							1869457.4

Shënim : Përfundon me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë)

TOTALI I GRANTIT TE MENJEHERSHEM.....1 869 457,4 lek

PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE

DREJTORI

ARDIAN ILJAZAJ






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 54 prot.
13

Durrës, më 24 . 07 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës
KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 49 datë 23.07.2025 “Për miratimin e listës emërore të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e grantit të menjëhershëm që do të akordohet nga ministria e ekonomisë, kulturës dhe inovacionit në favor të Bashkisë Durrës për familjet që përfitojnë ulje të vlerës së kontratës për vitin 2025”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

PREFEKTI
EMILJAN JANI

